



Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës,,

Në mbështetje të nenit 3.1, 25.1 (a),(c), 32, 33, 37, 38, 40, 41, 42, 44, 46, 47, 48, 49, 57, 58, 59, 61, 62, 66, 69, 72, 73, 75, 78 dhe 79 të Ligjit Nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Viti III/ Nr. 28, më 04 qershor 2008), dhe nenit 11.1 të Rregullores për organizimin dhe funksionimin e brendshëm dhe sistemimin e vendeve të punës, datë 17 janar 2011,

Me qëllim të përcaktimit të sistemit të tarifave dhe shpenzimeve të ngarkuara në lidhje me shërbimet e ofruara dhe kryerjen e aktiviteteve inspektuese nga Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës,

Me qëllim të promovimit të rritjes dhe përkrahjes së zhvillimit të qëndrueshëm të aviacionit civil në Republikën e Kosovës,

Pas përfundimit të procesit të konsultimit publik të palëve të interesit sipas Udhëzimit Administrativ nr. 01/2012 për procedurat e konsultimit publik të palëve të interesit ,

Nxjerr këtë:

RREGULLORE NR. 2/2015
PËR TARIFAT E NGARKUARA NGA AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL I
KOSOVËS

KAPITULLI 1
FUSHËVEPRIMI

Neni 1
Zbatueshmëria

Kjo Rregullore do të zbatohet ndaj të gjithë personave fizikë dhe juridikë të cilët kërkojnë shërbime nga, ose i nënshtrohen një aktiviteti inspektues apo mbikëqyrës të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës.

Neni 2
Përkufizimet

Për qëllime të kësaj rregulloreje, shprehjet e përdorura kanë këtë kuptim:

“AAC” nënkupton Autoritetin e Aviacionit Civil të Kosovës dhe referimet në ngarkimin me tarifa dhe mbledhjen e tyre, do të interpretohen si referim në ngarkimin me tarifa dhe mbledhjen e tyre nga AAC;

“Aerodrom” - nënkupton:

- **Klasa A** - aerodromet me së paku një pistë të shtruar me gjatësi prej 1800 m apo më shumë, të cilat janë në dispozicion për shfrytëzim publik;
- **Klasa B** - aerodromet me së paku një pistë të shtruar me gjatësi 1200m apo më shumë por më pak së 1800m, të cilat janë në dispozicion për shfrytëzim publik;
- **Klasa C** - të gjitha aerodromet tjera

“SHNA” nënkupton Shërbimet e Navigacionit Ajror - duke i përfshirë, shërbimet e trafikut ajror; komunikimin, shërbimet navigacionit dhe survejimit; shërbimet meteorologjike për navigacionin ajror; dhe shërbimet informative aeronautike;

“Ofruesi i SHNA (OSHNA)” nënkupton një entitet publik ose privat që ofron shërbime të navigacionit ajror për trafikun e përgjithshëm ajror, i cili i nënshtrohet rregullimit nga AAC-ja;

“Konventa e Çikagos” nënkupton Konventën mbi Aviacionin Civil Ndërkombëtar, të nënshkruar në Çikago, të SHBA-ve më 7 dhjetor 1944 me të cilën është themeluar Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil (ICAO)

“Agjencia Evropiane për Sigurinë e Aviacionit - (EASA)” nënkupton Agjencinë e themeluar më 28 shtator 2003 me Rregulloren (EC) Nr. 1592/2002 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 15 korrik 2002 (këtu e tutje referuar si “Rregullorja e EASA-s”);

“HPEA ose Marrëveshja për HPEA” nënkupton Hapësirën e Përbashkët Evropiane të Aviacionit ose Marrëveshjen për themelimin e HPEA e cila përmban Marrëveshjen kryesore, shtojcat dhe protokollet e saj;

“Rregulloret e EASA-s” nënkupton rregulloren e EASA-s dhe secilën rregullore të nxjerrë nga ajo, duke i përfshirë të gjitha pjesët e rregulloreve të tilla dhe specifikacionet e tyre përcjellëse të certifikimit ashtu siç miratohen nga EASA;

“Pesha maksimale e ngritjes - (MTOW)” - sa i përket një mjeti ajror, për qëllim të kësaj rregulloreje, nënkupton peshën maksimale me të cilën mjetit ajror i lejohet të tentojë të ngritet, për arsye të kufizimeve strukturore apo tjera. MTOW zakonisht është e specifikuar në njësi të kilogramëve ose paundëve. MTOW është pesha më e madhe e mjetit ajror në të cilën është treguar se mjeti ajror i plotëson kërkesat e vlefshmërisë

ajrore të aplikueshme për të. MTOW e një mjeti ajror është fikse dhe nuk ndryshon me lartësinë apo temperaturën e ajrit apo me gjatësinë e pistës që shfrytëzohet për ngritje dhe aterrim;

“PJESA M” nënkupton Aneksin I të Rregullores së Komisionit (EC) Nr. 2042/2003, të amendamentuar, për vlefshmërinë e vazhdueshme ajrore të mjeteve ajrore dhe produkteve, pjesëve dhe pajisjeve aeronautike dhe për aprovimin e organizatave dhe personelit të përfshirë në këto detyra;

“PJESA 66” nënkupton Aneksin III të Rregullores së Komisionit (EC) 2042/2003, të amendamentuar, i cili merret me licencimin e personelit të mirëmbajtjes në kontekst të aprovimit të organizatave dhe personelit të përfshirë në detyra të vlefshmërisë së vazhdueshme ajrore të mjeteve ajrore dhe produkteve aeronautike;

“PJESA 145” nënkupton Aneksin II të Rregullores së Komisionit (EC) 2042 /2003, të amendamentuar, për vlefshmërinë e vazhdueshme ajrore të mjeteve ajrore dhe produkteve aeronautike dhe për aprovimin e organizatave dhe personelit të përfshirë në këto detyra, i cili merret me aprovimin e organizatave të mirëmbajtjes;

“PJESA 147” nënkupton Aneksin III të Rregullores së Komisionit (EC) 2042/2003, të amendamentuar, i cili merret me aprovimin e organizatave trajnuese për teknikët e mirëmbajtjes së mjeteve ajror në kontekst të aprovimit të organizatave dhe personelit të përfshirë në detyrat e vlefshmërisë së vazhdueshme ajrore të mjeteve ajrore dhe produkteve aeronautike;

“Qielli i Vetëm Evropian (SES)” nënkupton konceptin dhe grupin e rregulloreve mbështetëse për operim të mirë të sistemit të transportit ajror të kombinuar me një nivel të qëndrueshëm dhe të lartë të sigurisë në shërbimet e navigacionit ajror, duke mundësuar kështu shfrytëzimin optimal të hapësirës ajrore të Evropës dhe nivel të qëndrueshëm dhe të lartë të sigurisë në transportin ajror, në harmoni me detyrën e interesit të përgjithshëm të shërbimeve të navigacionit ajror, duke i përfshirë obligimet e shërbimit publik.

“Auditim rregullator i sigurisë” nënkupton një ekzaminim sistematik dhe të pavarur që kryhet nga, apo në emër të AAC-së për të përcaktuar nëse të gjitha aranzhimet që kanë të bëjnë me sigurinë apo elementet e saj, për proceset dhe rezultatet e tyre, produktet apo shërbimet, janë në pajtueshmëri me aranzhimet e kërkuara në lidhjen me sigurinë dhe nëse ato implementohen në mënyrë efektive dhe nëse janë të përshtatshme për t’i arritur rezultatet e pritura;

“Mbikëqyrja e sigurisë” nënkupton një funksion të ndërmarrë nga AAC-ja për të verifikuar që objektivat dhe kërkesat rregullatore të sigurisë janë plotësuar në mënyrë efektive.

Neni 3 **Të drejtat e AAC-së**

3.1 AAC-ja do të ngarkojë dhe mbledhë tarifa në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje.

3.2 AAC-ja do të kërkojë që 50% e tarifës së caktuar të cilat referohen në ndonjë nen përkatës të kësaj rregulloreje t'i paguhet AAC-së me rastin e dorëzimit të aplikacionit, ndërsa pjesa e mbetur prej 50% para lëshimit përfundimtar apo ripërtëritjes së certifikatës, licencës, aprovimit apo autorizimit në fjalë, apo para ndërmarrjes së një ekzaminimi apo testimi që i nënshtrohet një tarife sipas një neni përkatës. Tarifat më të vogla se 500 Euro, të cilat ngarkohen për shërbime të referuara në ndonjë nen përkatës të kësaj rregulloreje, duhet të paguhen në tërësi me rastin e dorëzimit të aplikacionit.

3.3 AAC-ja do ta pezullojë një licencë, certifikatë, aprovim apo autorizim në lidhje me të cilën poseduesi nuk i ka paguar AAC-së tarifën e cila kërkohet sipas një neni të kësaj rregulloreje. Licenca, certifikata, aprovimi apo autorizimi i pezulluar nga AAC-ja nuk do të konsiderohet i vlefshëm sa i përket personit, mjetit ajror apo organizatës me të cilën ndërlidhet, derisa të mos hiqet pezullimi nga AAC-ja.

3.4 Drejtori i Përgjithshëm mund të lëshojë urdhra në lidhje me tarifatat e përfshira në këtë rregullore për të zbatuar qëllimet e kësaj rregulloreje, siç mund të jetë e nevojshme dhe e përshtatshme.

3.5 Urdhërat sipas paragrafit 5 të këtij neni mund të lëshohen në formë të udhëzimeve administrative, rregullave, vendimeve, dhe procedurave .

3.6 Shkalla e tarifave në këtë rregullore është dhënë në Euro (€). Secila faturë e AAC-së, e cila është lëshuar për ndonjë shërbim sipas neni përkatës të kësaj rregulloreje, duhet të paguhet brenda periudhës prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të saj në përputhje me procedurën e brendshme të përshkruar në ndonjë urdhër sipas paragrafit 5. Dështimi për të paguar faturën në kohën e duhur, rezulton me pezullim të shqyrtimit të lëndës.

3.7 Shpenzimet lidhur me aktivitetet e mbikëqyrjes në përputhje me dispozitat e neni përkatës të kësaj rregulloreje që realizohen jashtë territorit të Republikës së Kosovës, të cilat përfshijnë shpenzimet e udhëtimit, akomodimit dhe mëditjes së inspektorit do të mbulohen nga operatori.

3.8 Inspektimet dhe kontrollet e fluturimit të cilat realizohen nga ekspertë ose ekzaminerë të angazhuar nga AAC-ja për këtë qëllim, do t'i nënshtrohen një tarife shtesë e cila i ngarkohet operatorit, por vetëm në rast se pjesa shtesë e tejkalon tarifën e caktuar në dispozitat e kësaj rregulloreje.

3.9 AAC mban të drejtën për të kërkuar të drejtat e saj që dalin nga kjo rregullore përmes procedurës gjyqësore, në përputhje me ligjin e aplikueshëm.

KAPITULLI 2 MJETET AJRORE

Neni 4 Tarifat për regjistrimin e mjetit ajror

AAC do të ngarkojë dhe mbledhë tarifa për secilin aplikacion për regjistrim të mjetit ajror, duke përfshirë gllajderët dhe balonët, në regjistrin/evidencën e mjeteve ajror civile, në përputhje me shkallën si në vijim:

Tabela 4A: Regjistrimi, ri-regjistrimi dhe regjistrimi përkohshëm i një mjeti ajror që nuk është i regjistruar në Regjistrin e Mjeteve Ajrore Civile të Kosovës

		Tarifa e lëshimit
A1	Regjistrimi i mjetit ajror deri në 560 kg MTOM	50
A2	Regjistrimi i mjetit ajror mbi 560 kg deri 2 730 kg-	100
A3	Regjistrimi i mjetit ajror (mbi 2730 kg deri në 5700 kg MTOM)	200
A4	Regjistrimi i mjetit ajror mbi 5700 kg MTOM	500

Tabela 4B: Regjistrimi i ndërrimit të pronësisë, ndërrimit të përdoruesit, largimin e regjistrimit të përkohshëm dhe largimin e mjetit ajror nga Regjistri i Mjeteve Ajrore Civile të Kosovës

		Tarifa e lëshimit
B1	Regjistrimi i ndërrimit të pronarit apo përdoruesit, largimi i mjetit ajror	50

Neni 5 Tarifat për Certifikatat e vlefshmërisë ajrore

5.1 AAC-ja do të ngarkojë dhe mbledhë tarifa për lëshimin e certifikatës së vlefshmërisë ajrore, për lëshimin e deklaratës për eksport, lejes për fluturim, certifikatës së zhurmës apo certifikatës së emetimit dhe lëshimin apo ripërtëritjen e certifikatës së verifikimit të vlefshmërisë ajrore (ARC), në përputhje me shkallën si në vijim:

Tabela 5A: Certifikata e Vlefshmërisë Ajrore

Mjeti ajror

Qëllimi	Kategoria e m.ajror		
	Transport	Përgjithshëm	Veçantë
Komercial	700	300	100
Privat	350	150	50

Tabela 5B: Lizingu i mjetit ajror që është në Regjistrin e Mjeteve Ajrore Civile të Kosovës

		Tarifa e lëshimit
B1	Pagesa për procedurat në lidhje me dhënien në lizing të mjetit ajror që është në Regjistrin e Mjeteve Ajrore Civile të Kosovës tek shtetet anëtare të HPEA (ECAA)	3.000
B2	Pagesa për procedurat në lidhje me dhënien në lizing të mjetit ajror që është në Regjistrin e Mjeteve Ajrore Civile të Kosovës tek shtetet jo anëtare të HPEA (ECAA)	5.000

Tabela 5C: Deklaratat për eksport

		Tarifa e lëshimit
C1	Deklarata për eksport	1.500

Tabela 5D: Leja për fluturim

		Tarifa e lëshimit
D1	Leja për fluturim	1.500
D2	Ripërtëritja e Lejes për fluturim	750
D3	Validimi i Lejes së huaj për fluturim	1.000

Tabela 5E: Certifikata e zhurmës dhe/ose certifikata e emetimit

		Tarifa e lëshimit
E1	Certifikata e zhurmës dhe/ose certifikata e emetimit	200

Tabela 5F: Certifikata e Verifikimit të Vlefshmërisë Ajrore (ARC)

F1	Certifikata e Verifikimit të Vlefshmërisë Ajrore (ARC)	100

5.2 Kur mjeti ajror është i vendosur në një shtet tjetër sipas një marrëveshjeje për lizing që është e pranueshme për AAC-në dhe që operohet nga një operator që nuk është posedues i certifikatës së operatorit ajror të lëshuar nga AAC-ja, tarifat e dhëna në tabelën 5A të këtij neni do të aplikohen për atë mjet ajror.

Neni 6

Tarifat për Delegimin e Mbikëqyrjes sipas Nenit 83bis të Konventës së Çikagos

6.1 Kur mbikëqyrja e sigurisë së një mjeti ajror i delegohet një shteti anëtar të HPEA-së sipas dispozitave të nenit 83bis të Konventës së Çikagos, atëherë do të mblidhet një tarifë vjetore prej (€) 8 për 500 kg të MTOW. Tarifa do të llogaritet nga e njëjta datë sikurse edhe data e ripërtëritjes apo vazhdimit të certifikatës të vlefshmërisë ajrore ose data e rilëshimit të Certifikatës së Verifikimit të Vlefshmërisë Ajrore për mjetin ajror në fjalë.

6.2 Kur mbikëqyrja e sigurisë së një mjeti ajror i delegohet një shteti anëtar të ICAO-s, e i cili nuk është shtet anëtar i HPEA-së, sipas dispozitave të nenit 83bis të Konventës së Çikagos, atëherë do të mblidhet një tarifë vjetore prej (€) 15 për 500 kg të MTOW. Tarifa do të llogaritet nga e njëjta datë sikurse edhe data e ripërtëritjes apo vazhdimit të certifikatës së verifikimit të vlefshmërisë ajrore për mjetin ajror në fjalë.

KAPITULLI 3 INSPEKTIMET DHE MBIKËQYRJET

Neni 7

Tarifat për inspektim me qëllim të lëshimit të aprovimit të një Organizate për Mirëmbajtje apo Riparim Kapital apo apër Pjesën 145

7.1 AAC do të ngarkojë dhe mbledhë një tarifë për inspektim të një organizate me qëllim të lëshimit të aprovimit, duke qenë qenë aprovimi i Pjesës 145, si organizatë që është kompetente për të kryer riparime kapitale dhe për të mirëmbajtur mjetet ajrore dhe komponentët e tyre, në përputhje me tabelën 7A.

7.2 AAC do të ngarkojë dhe mbledhë një tarifë për kryerjen e rishikimit vjetor të manualit të përshkrimit të mirëmbajtjes Pjesa 145 të një organizate, në përputhje me tabelën 7A.

Tabela 7A: Aprovimi i Organizatës së Mirëmbajtjes

		Tarifa e lëshimit
A1	Aprovimit i Organizatës së Mirëmbajtjes (Pjesa 145) për mjet ajror më të lehtë se 570 kg. MTOM	200
A2	Aprovimit i Organizatës së Mirëmbajtjes (Pjesa 145) për mjet ajror me masë mbi 570 kg deri në 2 730 kg MTOM)	250
A3	Aprovimit i Organizatës së Mirëmbajtjes (Pjesa 145) për mjet ajror me masë mbi 2730 kg deri në 5 700 kg MTOM)	300

A4	Aprovimit i Organizatës së Mirëmbajtjes (Pjesa 145) për mjet ajror me masë mbi 5700 kg deri në 40000 kg MTOM)	1.500
A5	Aprovimit i Organizatës së Mirëmbajtjes (Pjesa 145) për mjet ajror me masë mbi 40 000 kg MTOM)	5.000

7.3 AAC do të ngarkojë dhe mbledhë tarifa për inspektim të një organizate me qëllim të lëshimit të aprovimit, duke qenë organizatë Pjesa M nënpjesa F, si organizatë kompetente për të mirëmbajtur mjetet ajrore dhe komponentët me masë prej dhe nën 5700 kg që nuk përdoren për transport komercial ajror, në përputhje me tabelën 7B.

7.4 AAC do të ngarkojë dhe mbledhë tarifa për kryerje të rishikimit vjetor të një organizate Pjesa M nënpjesa F, kompetente për të mirëmbajtur mjetet ajrore dhe komponentët me masë prej dhe nën 5700 kg që nuk përdoren për transport komercial ajror, në përputhje me tabelën 7B.

Tabela 7B: Aprovimi i Organizatës së Mirëmbajtjes

		Tarifa e lëshimit
B1	Aprovimi i Organizatës së Mirëmbajtjes (Pjesa M nënpjesa F)	500

Neni 8

Tarifat për certifikim fillestar dhe mbikëqyrje të vazhdueshme të Organizatave Pjesa M nënpjesa G

AAC-ja do të ngarkojë dhe mbledhë një tarifë për certifikim fillestar dhe mbikëqyrje të vazhdueshme të Organizatave Pjesa M nënpjesa G, jashtë kornizës së një Operatori Ajror, në përputhje me tabelën 8A.

Tabela 8A: Aprovimi i Organizatave Pjesa M nënpjesa G

		Tarifa e lëshimit
A1	Aprovimi i Organizatave Pjesa M nënpjesa G	1.000

Neni 9

Tarifat për inspektimin e Organizatës së operatorit komercial ajror për qëllim të dhënies, ripërtëritjes apo amendamentimit të Certifikatës së Operatorit Ajror (AOC)

9.1 AAC-ja do të ngarkojë dhe mbledhë tarifa për inspektimin dhe mbikëqyrjen e organizatës së operatorit ajror për qëllim të dhënies, ndryshimit apo ripërtëritjes së Certifikatës së Operatorit Ajror, në përputhje me tabelën 9A dhe 9B.

Tabela 9A: Certifikata e Operatorëve Ajror - Transporti ajror komercial

		Mjeti ajror i parë	Të tjerët
A1	Transporti ajror komercial (Më pak se 2 730 kg MTOW)	400	100
A2	Transporti ajror komercial Prej 2 730 kg deri në 5 700 kg MTOW)	1.500	500
A3	Transporti ajror komercial mbi 5 700 kg deri në 40 000 kg MTOW)	3.000	1.500
A4	Transporti ajror komercial (mbi 40 000 kg MTOW)	4.000	2.000
A5	Transporti ajror komercial (Balona me kapacitet të ulëseve të udhëtarëve më shumë se 40)	1.000	300
A6	Transporti ajror komercial (Balona me kapacitet të ulëseve të udhëtarëve nga 21 deri 40)	800	200
A7	Transporti ajror komercial (Balona me kapacitet të ulëseve të udhëtarëve më pak se 21)	500	100

Tabela 9B: Certifikata e Operatorëve Ajrorë - Punë nga ajri

		Mjeti ajror i parë	Të tjerët
B1	Certifikata e Operatorëve Ajror - Operimeve të Specializuara (SPO)	500	200

9.2 AAC-ja do të ngarkojë dhe mbledhë tarifa për çdo mjet ajror me qëllim të dhënies së aprovimit për Procedurat e Fluturimit Instrumental gjatë procedurave me shikueshmëri të zvogëluar, në përputhje me tabelën 9C.

Tabela 9C: Aprovimet speciale - Procedurat e fluturimit instrumental

		Cat II	Cat III
C1	Aviacioni komercial	500	750

	(Më pak se 5 700 kg MTOW)		
C2	Aviacioni komercial (Prej 5 700 kg deri në 40 000 kg (MTOW))	2.000	2.500
C3	Aviacioni komercial (Më tepër se 40 000 kg MTOW)	4.000	5.000

9.3 Në rast të aplikimit për dhënie të aprovimit specifik për operim të një tipi të mjetit ajror, tarifat do të ngarkohen dhe mbledhen për aprovim të tillë të secilit mjet ajror, në përputhje me tabelën 9D.

Tabela 9D: Aprovimet Speciale

	Aprovimet Speciale	Tarifa e leshimit
D1	Minimumi i Zvogëluar i Ndarjes Vertikale (RVSM)	1.000
D2	Ngritje gjatë dukshmërisë së ulët (LVTO)	1.500
D3	Specifikacioni i performancës minimale të navigacionit (MNPS)	1.000
D4	Navigacioni i bazuar në Performancë (PBN)/ Navigacioni në Zonë (RNAV)/ Performanca e kërkuar e navigacionit (RNP)	1.000
D5	Standardet e performancës operationale të distancës së zgjatur të fluturimit me dy motorë (ETOPS)	1.000
D6	Transport i mallrave të rrezikshme	1.000
D7	Sistemi i shikueshmërisë të imazheve gjate natës (NVIS)	1.000
D8	Operimet e ngritjeve/hoist me helikopter (HHO)	1.000
D9	Shërbimet mjekësore emergjente me helikopter (HEMS)	1.000
D10	Operimet e specializuara komerciale me rrezikshmëri të lartë (SPO)	1.000

9.4 AAC-ja do të ngarkojë dhe mbledhë tarifa për aprovim të pjesëve të caktuara të manualit të operimeve të operatorit ajror (siç kërkohet me EU-OPS) në shumë prej (€) 300.

Neni 10

Tarifat për inspektimin e mjetit ajror për të përcaktuar nëse ka vlefshmëri ajrore

AAC-ja do të ngarkojë dhe mbledhë tarifa për inspektim, kur bëhet aplikimi nga pronari i mjetit ajror (duke mos qenë inspektim i bërë me qëllim të lëshimit apo ripërtërirjes apo miratimit të certifikatës së vlefshmërisë ajrore apo lëshimit të certifikatës së vlefshmërisë ajrore për mjetin ajror që është i dedikuar për eksport) me qëllim të sigurimit që mjeti ajror ka vlefshmëri ajrore dhe i plotëson kërkesat për lëshimin e certifikatës së vlefshmërisë ajrore, ashtu siç është e përshtatshme për mjetin ajror në fjalë, sipas nenit 5 të kësaj rregulloreje.

Neni 11
Tarifat për aprovimin e Organizatave trajnuese

AAC-ja do të ngarkojë dhe mbledhë tarifa për dhënien dhe ripërtëritjen e aprovimit të Organizatës Trajnuese të Aprovuar (ATO), Organizatës trajnuese për klasifikim për tipin (TRTO), Pajisjeve të trajnimit për simulim të fluturimit (FSTD), dhe Organizatës trajnuese Pjesa 147 për teknikët e mirëmbajtjes së mjeteve ajrore në përputhje me tabelat në vijim:

		Tarifa e lëshimit	Ndryshimi	Ripërtëritja
--	--	-------------------	-----------	--------------

Organizata Trajnuese e Aprovuar (ATO)

Tabela 11A :

A1	Organizata Trajnuese e Aprovuar (ATO)	1.000	100	500
----	---------------------------------------	-------	-----	-----

Organizata trajnuese për klasifikim për tipin (TRTO)

Tabela 11B:

B1	Organizatrat trajnuese për klasifikim për tipin (TRTO)	3.000	100	1.500
----	--	-------	-----	-------

Pajisjeve të trajnimit për simulim të fluturimit (FSTD)

Tabela 11C:

C1	Pajisjet e trajnimit për simulim të fluturimit (FSTD)	4.000	100	2.000
----	---	-------	-----	-------

Objektet e regjistruara Vetëm për trajnimin PPL

Tabela 11D:

D1	Objektet e regjistruara Vetëm për trajnimin PPL	250	100	100
----	---	-----	-----	-----

Organizata Trajnuese të Aprovuara për Glajder dhe Balona

Tabela 11E:

E1	Organizata Trajnuese të Aprovuara për Glajder dhe Balona	100	20	50
----	--	-----	----	----

Organizata Trajnuese për mjete ajrore Mikro të lehta, Paraglajder, Deltaplan dhe Parashutizëm

Tabela 11F:

F1	Organizata Trajnuese për mjete ajrore Mikro te lehta Paraglajder, Deltaplan dhe Parashutizëm	100	20	50
----	--	-----	----	----

Neni 12

Tarifat për mallërat e rrezikshme

AAC-ja do të ngarkojë dhe mbledhë tarifa për mallërat e rrezikshme në përputhje me tabelën në vijim:

	Mallërat e rrezikshme	Tarifa e lëshimit
A1	Lëshimi/vazhdimi i certifikatës për mallëra të rrezikshme	500
A2	Lëshimi/vazhdimi i certifikimit të ofruesit të trajnimit për mallëra të rrezikshme □	500
A3	Pranimi i instruktorit për mallëra të rrezikshme	50
A4	Inspektimet e entiteve për lëshimin/vazhdimin e certifikatës për mallëra të rrezikshme	400
A5	Aprovim/vazhdimi i kursit trajnues për mallërat e rrezikshme	400

KAPITULLI 4

LICENCAT DHE CERTIFIKIMET E EKUIPAZHIT

Neni 13

Tarifat për Licencat e ekuipazhit të fluturimit, Licencat Pjesa 66 për mirëmbajtje të mjeteve ajrore, Certifikatat mjekësore dhe Klasifikimet për zotërimin e gjuhës

AAC-ja do të ngarkojë dhe mbledhë tarifa për lëshim fillestar, ripërtërirje, validim fillestar, validime pasuese dhe zëvendësime të licencave dhe klasifikimeve të lidhura për Licencat e ekuipazhit të fluturimit (FCL), Licencat Pjesa 66 për mirëmbajtje të mjeteve ajrore, Certifikatat mjekësore dhe Klasifikimet për zotërimin e gjuhës, në përputhje me tabelat në vijim:

Tabela 13A: Licencat FCL

		Lëshimi fillestar	Ripërtërirja	Validimi	Konvertimi	Zëvendësimi
A1	Licencë për mjet ajror të lehtë (LAPL)	70	35	35	70	35
A2	Licencë për pilot privat (PPL)	100	50	50	100	50
A3	Licencë për pilot të Velores/Glajder (SPL)	50	25	25	50	25
A4	Licencë për pilot të balonës (BPL)	70	35	35	70	35

A5	Licencë për pilot komercial (CPL)	200	100	100	200	100
A6	Licencë për pilot të transportit ajror (ATPL)	300	150	150	300	150
A7	Licencë për pilot multi-ekuipez (MPL)	200	100	100	200	100
A8	Licencë për inxhinier të fluturimit (FE)	150	100	150	100	75
A9	Licencë për instruktor të fluturimit (FI)	150	75	75	150	75
A10	Klasifikimi për tip	100	50			
A11	Klasifikimi për klasë	100	50			
A12	Klasifikimi për IR	100	50			
A13	Klasifikimi për natë	100	50			
A14	Klasifikimi për fluturime Akrobatike	100	50			
A15	Klasifikimi për tërheqje të Velores/Glider dhe banerave	100	50			
A16	Klasifikimi për fluturim malor	100	50			
A17	Klasifikimi për fluturime testuese	100	50			
A18	Ekuipezi i kabinës	70	35	35	70	35
A19	Licencë për Paraglajder, deltaplan dhe parashuta	50	35	35	50	35

Tabela 13B: Licencat teknike

		Lëshimi fillestar	Ripërtëritja	Validimi fillestar	Validimi pasues	Zëvendësimi

B1	Licenca M/ AML Pjesa 66	100	50	50	100	50
----	----------------------------	-----	----	----	-----	----

Tabela 13C: Licencat mjekësore

		Lëshimi fillestar	Ripërtërirja	Validimi fillestar	Validimi pasues	Zëvendësimi
C1	Certifikata Mjekësore	70	70	N/A	N/A	35

Tabela 13D: Klasifikimi për zotërimin e gjuhës

		Lëshimi fillestar	Ripërtërirja	Validimi fillestar	Validimi pasues	Zëvendësimi
D1	Klasifikimi për zotërimin e gjuhës	70	N/A	N/A	N/A	N/A

Neni 14

Tarifat për alokimin dhe lëshimin e kodeve të transponderit të formës 'S' për pajisjet e vendosura në tokë

AAC-ja do të ngarkojë dhe mbledhë një tarifë për alokimin dhe lëshimin e kodit të transponderit të formës 'S' në shumë prej (€) 100.

KAPITULLI 5 AERODROMET DHE HELIPOINTET

Neni 15

Tarifat për certifikimin/aprovimin e aerodromeve

AAC-ja do të ngarkojë dhe mbledhë tarifa për dhënie, ripërtëritje, amendamentim dhe transferim të Certifikatës/Aprovimit të Aerodromit, në përputhje me tabelën në vijim:

Tabela 15A: Certifikimi i Aerodromeve - tarifat e lëshimit të certifikatës

	Klasa e aerodromit	Tarifa
A1	Certifikata Klasa A	20.000
A2	Certifikata Klasa B	10.000
A3	Certifikata Klasa C	5.000

A4	Amendamentim/Transferim i Certifikatës Klasa A	20.000
A5	Amendamentim/Transferim i Certifikatës Klasa B	10.000
A6	Amendamentim/Transferim i Certifikatës Klasa C	5.000
A7	Ripërtërirja e Certifikatës Klasa A	10.000
A8	Ripërtërirja e Certifikatës Klasa B	5.000
A9	Ripërtërirja e Certifikatës Klasa C	2.500

Tabela 15B: Tarifat vjetore për aerodromet e certifikuara

	Klasa e aerodromit	Tarifa vjetore
B1	Aerodromet - Klasa A	5.000
B2	Aerodromet - Klasa B	2.500
B3	Aerodromet - Klasa C	1.250

Tabela 15C: Aprovimi i Aerodromeve- tarifat e lëshimit të Aprovimit

	Klasa e aerodromit	Tarifa
C1	Aprovimi - Klasa A	8.000
C2	Aprovimi - Klasa B	4.000
C3	Aprovimi - Klasa C	2.000
C4	Amendamentim/Transferim i Aprovimit - Klasa A	8.000
C5	Amendamentim/Transferim i Aprovimit - Klasa B	4.000
C6	Amendamentim/Transferim i Aprovimit - Klasa C	2.000
C7	Ripërtërirja e Aprovimit - Klasa A	4.000
C8	Ripërtërirja e Aprovimit - Klasa B	2.000
C9	Ripërtërirja e Aprovimit - Klasa C	1.000

Tabela 15D: Tarifat vjetore për aerodromet e aprovuara

	Klasa e aerodromit	Tarifa vjetore
D1	Aerodromet - Klasa A	2.000
D2	Aerodromet - Klasa B	1.000
D3	Aerodromet - Klasa C	500

Tarifa vjetore për aerodromet e certifikuara/aprovuara nuk do të ngarkohet në vitin e lëshimit të certifikatës/aprovimit.

Së paku tre (3) muaj para skadimit të vlefshmërisë së certifikatës/aprovimit, operatori i aerodromit duhet t'ia paraqesë AAC-së kërkesën për ripërtërirje (vazhdimin) e certifikatës/aprovimit.

Në rastet kur mbajtësi i certifikatës /aprovimit (Operatori) kërkon amendamentim jo substancial të certifikatës/aprovimit ndryshe nga neni 13 nën a), b) apo c) sipas rregullores nr. 1/2008 për Aerodromet, përkatësisht rregullores nr. 3/2012 për Aerodromet e aprovuara, aplikohet tarifa e njëjtë me atë vjetore.

Neni 16 **Tarifat për certifikimin/aprovimin e heliporteve**

AAC-ja do të ngarkojë dhe mbledhë tarifa për dhënie, ripërtërirje, amendamentim dhe transferim të Certifikatës/Aprovimit të Heliportit në përputhje me tabelën në vijim:

Tabela 16A: Certifikimi i heliporteve

		Tarifa
A1	Certifikata	5.000
A2	Amendamentimi / transferimi i certifikatës	5.000
A3	Ripërtërirja e certifikatës	2.500
A4	Tarifa vjetore	1.250

Tabela 16B: Aprovimi i heliporteve

		Tarifa
B1	Aprovimi	2.000
B2	Amendamentimi / transferimi i aprovimit	2.000
B3	Ripërtërirja e aprovimit	500
B4	Tarifa vjetore	500

Tarifa vjetore për heliporte të certifikuar/aprovuara nuk do të ngarkohet në vitin e lëshimit, amendamentimit/transferimit apo ripërtërirjes së certifikatës/aprovimit.

Në rastet kur mbajtësi i Certifikatës /Aprovimit (Operatori) kërkon amendamentim jo substancial të Certifikatës/Aprovimit ndryshe nga neni 13 nën a),b) apo c) sipas rregullores nr. 1/2008 për Aerodromet, përkatësisht rregullores nr. 3/2012 për Aerodromet e aprovuara, aplikohet tarifa e njëjtë me atë vjetore.

Së paku tre (3) muaj para skadimit të vlefshmërisë së certifikatës/aprovimit, operatori i heliportit duhet t'ia paraqesë AAC-së kërkesën për ripërtërirje (vazhdimin) e certifikatës/aprovimit.

Neni 17

Tarifat për autorizimin e organizatave për aftësi profesionale në fushën e operimeve të aerodromeve

AAC-ja do të ngarkojë dhe mbledhë tarifa për dhënie, ripërtëritje, amendamentim dhe transferim të autorizimit për organizatat për aftësi profesionale në fushën e operimeve të aerodromeve si në vijim:

Tabela 17A: Autorizimi për organizata për aftësi profesionale

		Tarifa
A1	Lëshimi i autorizimit	1.000
A2	Ripërtëritja e autorizimit	500
A3	Tarifa për ndryshime/transfer	250
A4	Tarifa vjetore	250

Tarifa për miratimin e instruktorit për të punuar në punët e aftësitimit profesional është 350 €. Kjo tarifë nuk do të ngarkohet me rast të lëshimit të autorizimit për punë të organizatave për aftësi profesionale.

Neni 18

Tarifat për lëshimin e aprovimeve të shërbimeve në tokë

AAC-ja do të ngarkojë dhe mbledhë tarifa për lëshim, mbikëqyrje, ripërtëritje apo amendamentim të një aprovimi për ofrimin e shërbimeve në tokë në përputhje me rregulloren Nr. 04/2011 për Qasjen në tregun e shërbimeve në tokë, si vijon:

Tabela 18A: Shërbimi në tokë

		Tarifa e lëshimit	Tarifa vjetore ¹
A1	Aprovimi fillestar i kompanive të shërbimit në tokë	5.000	2.000
A2	Ripërtëritja e aprovimit	2.500	2.000

¹ Tarifa vjetore nuk do të ngarkohet në vitin e lëshimit, vazhdimin ose amendamentimit të aprovimit

A3	Amendamentimi i aprovimit (shtohet një aerodrom/rritet ose zvogëlohet sfera e aktiviteteve të shërbimeve në tokë ose vetë-shërbimeve)	2.000	2.000
----	---	-------	-------

KAPITULLI 6 OFRUESIT E SHËRBIMEVE TË NAVIGACIONIT AJROR

Neni 19

Tarifat për certifikimin e ofruesit të shërbimeve të navigacionit ajror

AAC-ja do të ngarkojë dhe mbledhë tarifa për dhënie, amendamentim të Certifikatës së OSHNA-s, dhe mbikëqyrje të sigurisë, në përputhje me tabelën në vijim:

Tabela 19A: Certifikata e OSHNA-s

		Tarifa e lëshimit	Tarifa vjetore
A1	Lëshimi i certifikatës	20,000	NA
A2	Ripërtërirja e certifikatës	10,000	NA
A3	Ndryshimi i certifikatës	500	NA
A4	Mbikëqyrja e sigurisë së OSHNA-s	NA	5.000

Tabela 19B: Pranimi i ndryshimeve në sistemet e OSHNA-s, përfshirë instalimin e sistemeve dhe pajisjeve të reja

		Tarifa e lëshimit
B1	Ndryshimi i madh	2.000

Neni 20

Tarifat për dhënie, ripërtërirje dhe amandamentim të Certifikatës për Organizatat Trajnuese për SHNA

AAC-ja do të ngarkojë dhe mbledhë tarifa për dhënie, ripërtërirje dhe amendamentim të Certifikatës për institutin e trajnimit të OSHNA-së, në përputhje me tabelën në vijim:

Tabela 20A: Certifikimi i organizatave trajnuese për SHNA

		Tarifa e lëshimit
A1	Dhënia e certifikatës	2.000
A2	Ripërtërirja e certifikatës	1.000
A3	Amendamentimi i certifikatës	500

Neni 21
Tarifa për Licencën e kontrollorit të trafikut ajror

AAC-ja do të ngarkojë dhe mbledhë tarifa për lëshim fillestar, ripërtëritje dhe amendamentim të licencës së kontrollorit të trafikut ajror, në përputhje me tabelat në vijim:

Tabela 21A: Licencat e kontrollorëve të trafikut ajror

		Tarifa e lëshimit
A1	Dhënia e licencës për kontrollor të trafikut ajror	100
A2	Ripërtëritja e licencës për kontrollor të trafikut ajror	50
A3	Amendamenti i licencës për kontrollor të trafikut ajror	50
A4	Shtimi/ripërtëritja e një klase apo miratimi ²	50
A5	Dhënia e licencës për kontrollor student të trafikut ajror	20

Neni 22
Tarifa për miratim të Procedurave për Fluturim Instrumental

AAC do të lëshojë dhe mbledhë tarifa për miratim të procedurave të reja apo të përditësuara për Procedurat e Fluturimit Instrumental në përputhje me tabelën si vijon:

Tabela 22A: Miratimi i Procedurave për Fluturim Instrumental

	Tarifa e lëshimit
A1: Miratimi i dizajnerit për PFI	50
A2: Miratimi i PFI të reja apo të përditësuara të PFI	100

KAPITULLI 7
DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 23
Tarifa dhe ngarkesa të ndryshme

² Duke përfshirë: Ratings/Rating Endorsements/Unit Endorsements/Language Endorsements/OJTI and Examiner Endorsements

23.1 Nëse AAC-ja ngarkohet nga ICAO apo EASA për shërbimet e ofruara ndaj një personi fizik apo juridik që operon në Republikën e Kosovës në kuadër të auditimeve të rregullta apo të jashtëzakonshme, AAC-ja do t'ia ngarkojë këtë shumë personit fizik apo juridik përkatës.

23.2 Çdo tarifë e cilat paguhet për dhënien e ndonjë përjashtimi, leje apo një ndryshimi në kategori apo klasë të ndonjë certifikate ose licence të lëshuar nga AAC-ja në përputhje me kërkesat e legjislacionit përkatës, e që përndryshe nuk është saktësuar këtu, do të ngarkohet dhe mbledhet në shumë prej pesëdhjetë (50 euro).

Neni 24 **Dispozitat kalimtare**

24.1 Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje shfuqizohet Rregullorja nr. 7/2011 për Tarifat e mbledhura nga AAC dt. 15 gusht 2011.

24.2 Përjashtimisht, paragrafit 1, për të gjithë aplikantët të cilët kanë dorëzuar në AAC një aplikacion për certifikatë, licencë ose leje para hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje, do të zbatohen dispozitat përkatëse të Rregullores nr. 7/2011, nëse nuk janë në kundërshtim me dispozitat e kësaj rregulloreje për një periudhë që nuk kalon gjashtë (6) muaj kalendarikë pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje.

Neni 25 **Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 6 maj 2015.

Prishtinë, më 20 prill 2015.

Dritan Gjonbalaj
Drejtor i Përgjithshëm